



Z. Edi Rama

Kryetar

Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile

Z. Artur Bushi

Kryetar

Bashkia Krujë

Nr. 180 Prot.

Tiranë, më 31 Dhjetor 2019

Qindra qytetarë, kryesisht të zonës së Thumanës, të cilët kanë mbetur të pastrehë, pas tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 dhe që janë strehuar në mënyrë të përkohshme në Hotel Rafaelo, në Shëngjin, Lezhë, kanë bërë prezent një shqetësim të thellë për kërkesën e disa personave të paidentifikuar (të prezantuar si punonjës të Bashkisë Krujë), të cilët i kanë kërkuar që në datën 3 Janar 2020, të lënë hotelin, të gjejnë vetë një mundësi tjetër strehimi dhe të plotësojnë dokumentacionin për përfitimin e një bonusi qiraje në vlerën e 3000 lekë për person.

Edhe pse ka kaluar më shumë se 1 muaj nga tragjedia që preku vendin tonë, ku një nga zonat më të prekura ishte pikërisht Thumana, qytetarët dëshmojnë që asnjë përfaqësues i qeverisjes qendrore apo lokale, nuk ka marrë kontakt me ta dhe nuk i ka dhënë asnjë informacion se çfarë do të bëhet me banesat e tyre të prishura nga tërmeti dhe sesi do të veprohet me strehimin e tyre gjatë kësaj kohe. Kjo mungesë informacioni, që shfaqë mungesë të theksuar përgjegjshmërie nga ana e strukturave shtetërore, është burim shqetësimi për qytetarët, të cilët po përjetojnë momentet më të vështira, pas tragjedisë së 26 Nëntorit.

Gjatë një takimi të zhvilluar me këta banorë (rreth 300 qytetarë), mes tyre gra, fëmijë, të moshuar dhe persona me probleme të rënda shëndetësore, doli në pah mungesa e angazhimit të strukturave shtetërore, për t'i ofruar atyre ndihmë gjatë këtyre ditëve, ku ka munguar minimalisht edhe kujdesi shëndetësor ndaj tyre, apo ndihma për të ndjekur procedurat ligjore për plotësimin e dokumentacionit për të përfituar ndërtimin e banesës apo marrjen e bonusit të

qirasë për strehim të përkohshëm. Kjo ka shkaktuar paqartësi tek qytetarët të cilët dëshmojnë se po kalojnë momente terrori psikologjik, ku nga njëra ana përballen me kërkesën për të dalë nga ambientet e hotelit, dhe nga ana tjetër përballen me mungesën e mundësisë për strehim të përkohshëm dhe mungesën e plotë të informacionit sesi do të veprohet me banesat e tyre.

Situata e paraqitur nga këta banorë, dëshmon edhe njëherë në mënyrë të pakundërshtueshme, se mekanizmat ligjor të parashikuara nga ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" kanë dështuar plotësisht. Në këtë kuadër, në përmbushje të detyrimeve ligjore që kanë autoritetet shtetërore, përfshirë detyrat e caktuara në ligjin nr. 45/2019, kërkojmë nga ana juaj, marrjen e menjëhershme të masave si më poshtë:

- 1- **Ofrimin e menjëhershëm të ndihmës shëndetësore** për të gjithë banorët që kanë nevojë dhe që ndodhen në strehuar në Hotel Rafaelo.
- 2- **Krijimin e kushteve për strehim të përkohshëm, në kushte normale jetese për këta banorë**, gjatë periudhës që nevojitet për sistemin e tyre në banesat e reja. Deri në përmbushjen e kësaj mase asnjë banorë nuk duhet të detyrohet të dalë jashtë ambientit ku strehohen aktualisht dhe Qeveria duhet të paguajë strehimin e tyre në Hotelin ku ndodhen. Bonusi i qirasë, në vlerën 3000 lekë për person, është i pamjaftueshëm që vetë banorët të gjejnë mundësi për strehim në banesa të marrë vetë prej tyre me qira. Vlera e qirasë është shumë herë më e lartë sesa masa që mbulon bonusi i qirasë, dhe shumica dërrmuese e banorëve janë në pamundësi financiare për të siguruar kompensimin e vlerës që nuk mbulon bonusi i qirasë. Këshilli Bashkiak i Krujës, duhet të rishikojë menjëherë vlerën e bonusit të qirasë për të gjitha familjet që kanë mundësi të gjejnë banesa me qira, duke bërë kompensimin e vlerës së plotë të qirasë. Ndërkohë që për familjet që janë në pamundësi për ta gjetur vetë banesën me qira, për shkak të gjendjes shëndetësore apo shkaqeve të tjera, të jenë autoritetet lokale që gjejnë dhe sigurojnë strehimin e tyre në kushte normale jetese.
- 3- **Dërgimin e përfaqësuesve të autoriteteve shtetërore dhe lokale, për të informuar banorët e strehuar atje sesi do të veprohet me banesat e tyre**, si dhe për ti ofruar asistencë ligjore për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, duke shmangur burokracitë e panevojshme dhe kërkesat për dokumentacion jashtë mundësive të qytetarëve. Autoritetet përgjegjëse të sigurojnë banorët për kompensimin e plotë të vlerës së dëmit të pësuar, duke qenë se shumicës prej tyre i janë prishur banesat pa patur mundësi që të marrin gjerat e nevojshme që ndodheshin brenda në banesë. Për pasojë, këta qytetarë

kanë humbur gjithçka kishin siguruar gjatë jetës së tyre, me vështirësi dhe mundësi të kufizuara financiare.

- 4- **Ndërhyrjen e autoriteteve shtetërore për të siguruar që asnjë prej banorëve të prekur dhe që përkohësisht është strehuar larg qendrës së punës, të humbasë punën për këtë shkak.** Autoritetet lokale duhet të marrin masat për të siguruar transportin e qytetarëve që janë në marrëdhënie pune larg vendit ku strehohen aktualisht, nga vendi i strehimit për në qendrën e tyre të punës.

Në fund vlen të theksohet se autoritetet shtetërore duhet të angazhohen në përmbushje të përgjegjësive të tyre, pa qenë nevoja e veprimeve propagandistike, pa asnjë efekt real në ndihmë të qytetarëve të prekur. Askush prej banorëve nuk kërkon nga Qeveria apo Bashkia, as bamirësi dhe as përfitime të padrejta për shkak të situatës. Qartësia dhe një plan i plotë masash, duhet t'i bëhet menjëherë prezent qytetarëve të prekur nga tërmeti i 26 Nëntorit, sipas përgjegjësive ligjore që kanë autoritetet shtetërore në një situatë të tillë.

Përsa më lart, qytetarët mbeten në pritje të përmbushjes së përgjegjësive nga ana e autoriteteve qeveritare, qendrore dhe lokale, si dhe marrjes së masave si më sipër.

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

**Sekretari i Përgjithshëm
Gazment BARDHI**

